

VENDIM
Nr. 431, datë 11.7.2018

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE
TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).

2. AKUM-i është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për infrastrukturën (ministri).

3. AKUM-i është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim. AKUM-i mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale. Përgjegjësia e AKUM-it në fushën e mbetjeve urbane lidhet me planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas fushës së përgjegjësisë të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, e përcaktuar me vendimin nr. 504/2017, të Këshillit të Ministrave.

4. AKUM-i ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema e AKUM-it përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

5. Vula e AKUM-it ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. AKUM-i ka statusin e agjencisë kombëtare në nivel qendror, me seli në Tiranë.

7. AKUM-i drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm.

8. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, nëpunësve, punonjësve, që zbatojnë projekte me financim të huaj, si dhe punonjësve të tjerë, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

9. Struktura dhe organika e AKUM-it miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Rregu-llorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të AKUM-it miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të agjencisë.

10. AKUM-i ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, sipas pikës 3 të këtij vendimi, derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndërmarrjet e menaxhimit të infrastrukturës së mbetjeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.

11. AKUM-i e ushtron veprimtarinë e vet në këto fusha përgjegjësie shtetërore derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve të jenë të afta për të kryer funksionet, si më poshtë vijon:

a) Shërbimin e furnizimit me ujë dhe ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane;

b) Fushën e mbetjeve urbane, në lidhje me planifikimin territorial, infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

12. AKUM-i, nëpërmjet autoritetit të tij ligjor e teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor. AKUM-i mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve.

13. AKUM-i ushtron këto kompetenca specifike:

a) Propozon ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve dhe është pjesë e hartimit të politikave e strategjive kombëtare të tyre;

b) Monitoron zbatimin e strategjive sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimit të ujërave të ndotura, planifikimin territorial e infrastrukturën e mbetjeve dhe të implementimit të tyre;

c) Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) edhe për sa i përket planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, si dhe për implementimin e tyre, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale;

ç) Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të ITUN-eve, planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre;

d) Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve;

dh) Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;

e) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura e infrastrukturën e mbetjeve;

ë) Ka të drejtë të ushtrojë kontrolle, me karakter teknik, në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimit të ujërave të ndotura dhe infrastrukturës së mbetjeve;

f) Propozon treguesit dhe kriteret që duhet të arrijë çdo ofrues i shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në kontratën e performancës, e cila firmoset nga palët. Këto kriterë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe mbetjeve;

g) Mbështet politikëbërësit për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e të procedurave për procesin e kalimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të ndotura nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas kontratës së performancës, të lidhur ndërmjet palëve;

gj) Planifikon nevojat për trajnime dhe koordinon punën për realizimin e tyre;

h) Menaxhon dhe monitoron zbatimin e masterplanit kombëtar të ujësjellës-kanalizimeve dhe krijon e menaxhon platformën kombëtare të aseteve të ujësjellës-kanalizime, bazuar në sistemin GIS (*Geographical Information System*);

i) Është institucioni përgjegjës për zbatimin e masterplanit kombëtar të mbetjeve për sa i përket

planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve urbane;

j) Ushtron çdo të drejtë tjetër, të përcaktuar në akte ligjore e nënligjore;

k) Shërben si koordinues dhe asistues i qeverisë, kur kërkohet, dhe i njërive të qeverisjes vendore për nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe në planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve, si dhe ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në këto fusha. Asistenca e AKUM-it në fushën e planifikimit territorial dhe të infrastrukturës së mbetjeve jepet, ndërmjet të tjerave, por pa u kufizuar në, për qendrat e transferimit, investimet në impiantet e incenerimit, në përcaktimin e venddepozitimeve (urbane dhe inerte), për impiantet e riciklimit, të kompostimit dhe të trajtimit të ujërave të ndotura të lëndës së thatë, për impiantet e trajtimit të gazit, për rehabilitimin dhe mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese etj.;

l) Ka të drejtë të jetë pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta, sipas përcaktimeve të ligjit të vetëqeverisjes vendore.

14. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi rristrukturohet në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e AKUK-ut do të vazhdojnë të ushtrohen prej tij deri në fillimin e veprimtarisë së organeve të AKUM-it. Për nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve zbatohen dispozitat e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësit civilë në rastin e mbylljes dhe të rristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

16. Vendimi nr. 504, datë 6.7.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi